



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (d) e LVL-së, nenit 37, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, për realizimin e kompetencave vetanake lidhur me shfrytëzimin e tokës dhe të zhvillimit me qëllim të ofrimit të shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenjes sociale siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror etj. me theks të veçantë për përkujdesin për fëmijët e braktisur dhe përkujdesi ndaj të moshuarëve, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit, në seancën e mbajtur me date 16.08.2017, miraton këtë :

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të: “Qendra për Fëmijët e Braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpia për të Moshuarit” në Gjiçan.

1. Kuvendi i Komunës Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për nevoja të ndërtimit të “Qendra për Fëmijët e Braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpisë për të Moshuarit”, në ngastrën kadastrale:

P-70403013-01382-0, lloji i njësish : parcelë, lloji i pronës: pronë shoqërore, sipërfaqja 35950 m², nga e cila sipërfaqja prej 10000 m² (1 ha) i dedikohet “Shtëpisë për të Moshuar”, kurse sipërfaqja tjetër prej 25950 m² (2.59.50 ha) i dedikohet “Qendrës për Fëmijët e Braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve”. Pronarë i kësaj parcele është Republika e Kosovës ,

2. Me ndërtimin e “Qendrës për fëmij të braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpisë për të Moshuarit” në këtë lokacion, Komuna e Gjiçanit do t’i realizon kompetencat e veta ligjore lidhur me ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve tjera të mirëqenies sociale siç është përkujdesi për të cënueshmit, përkujdesi fëmijëror, përkujdesi ndaj të moshuarëve dhe autoritetin e vet do ta ushtron përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit.

3. Obligohet Drejtoria Komunale e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit që duke u bazuar në interesin publik më madhor, ta bënë ridestinimin dhe inkorporimin e “Qendrës për fëmij të braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpisë për të Moshuar” në Planin Zhvillimor Urban “ Qyteti i Gjiçanit” (nr.01-11735 të datës 30.10.2008) në të cilin përfshihet lokacioni ku gjindet ngastra kadastrale e përshkruar në pikën I të këtij vendimi.

4. Autorizohet Kryetari i Komunës që pas plotëfuqishmërisë së këtij Vendimi t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës lidhur me rregullimin e çështjes së shfrytëzimit të kësaj parcele e cila është prone e Republikës së Kosovës.

5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale e Komunës së Gjilanit dhe Drejtoria Komunale e Arsimit që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zbatoj të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe urbanistike lidhur me ndërtimin e objektit dhe infrastrukturës përcjellëse për nevoja të “Qendrës për fëmij të braktisur, fëmijë me nevoja të veçanta, mbrojtjen e nënës dhe fëmijëve” dhe “Shtëpisë për të Moshuarit”

6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

7. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen Vendimet e mëhershme: Vendimi, 01.nr.016-19934 i dt.29.02.2016; Vendimi, 01.nr.016-19971 i dt.29.02.2016 dhe Vendimi 01.nr.016-52217 i dt.31.05.2016.

Nr.01.016-84831

Gjilan, më 16.08.2017

Kryesuesja e KK-Gjilan

/Shpresa Kurteshi/